Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05-350/02-149503/26 dt. 02.10.2026, në emër të aplikuesit Plator Selimi, nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin ideor për ndërtimin kompleksit me 3 shtëpi individuale të banimit- shtëpi në varg, në kuadër të bllokut urban "F-F-01", të Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 106-7 ZK Prishtinë.
Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 06.11.2026 deri më 11.11.2026, në e-mail adresën: **urbanizmiprishtine@rks-gov.net**

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Shtëpi individuale banimore-3 shtëpi familjare në varg, me etazhitet B+P+2
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	5.00 m` nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	9.00 m`/5.0 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	6.00~9.00 m`/1.72~2.34 m` dhe 6.35~9.44 m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=30 %
g. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISGJ=50 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=0.6÷0.8
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=50 %,
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	1 vendparkim i jashtëm
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike? Po x Jo □ Nuk aplikohet □	
n. shfrytëzimi i propozuar a do te gjenerojë ndotje te mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth? Po □ Jo x Nuk aplikohet □ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore ne Zona te Mbrojtura, Zona te veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po □ Jo x Nuk aplikohet □ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.
Në të gjitha komentet që përfillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: _____

Komuna e Prishtinës Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net